



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 6

Tiranë – E enjte, 25 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 18, datë 12.1.2018	Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë..... 113
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 24.1.2018	Për planin vjetor të pranimi për vitin 2018 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil..... 114
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 24.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për licencimin e arkivave privatë” 115
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 24.1.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” 119
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 24.1.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 413, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme dhe trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, të objekteve shtetërore të veçuara, të privatizuara, të objekteve apo ndërtesave të shitura të ish- kooperativave bujqësore, si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit”, të ndryshuar..... 119
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 24.1.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 378, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i bllokut të kufizuar nga rrugët: “Sulejman Delvina”, “Medar Shtylla”, “Skënder Luarasi”, “Grigor Heba” dhe “Gjik Kuqali”, Tiranë”” 121

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 40, datë 24.1.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 803, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e familjeve të fshatrave Zall-Mëner dhe Bulçesh, komuna Zall-Bastar, që preken nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës”	125
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.1.2018	Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.....	125
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 24.1.2018	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria “Tokë bujqësore” në “Tokë urbane”, truall, të pasurive me numrat 29/6, 29/7, 29/8, 29/9, 29/10, 29/11, 29/12, 29/13, 29/14, 29/15, 29/16, 29/17, 29/18, 29/19 dhe 35/32, zona kadastrale 3365, fshati Shetaj, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës.....	131
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 19.1.2018	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 615, datë 27.2.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2016-1671, datë 25.5.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)	131

**VENDIM****Nr. 18, datë 12.1.2018****PËR SUBVENCIONIMIN E LIDHJES
SË KONTRATAVE DHE TË VENDOSJES
SË MATËSVE TË UJIT PËR
KATEGORITË NË NEVOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subvencionimin e tarifës së lidhjes së kontratës dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë.

2. Kategoritë në nevojë, që përfitojnë nga subvencionimi i lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit, janë si më poshtë vijon:

a) Familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;

b) Familjet që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, dhe që nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

c) Familjet që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

ç) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose që përfitojnë pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

3. Familjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat nuk disponojnë një kontratë të lidhur me ujësjellës-kanalizimet sh.a., do të përfitojnë lidhjen e kontratës së ujit pa pagesë.

4. Familjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat nuk janë të pajisura me matës të ujit në banesë, do të përfitojnë vendosjen e matësve pa pagesë.

5. Listat e kategorive të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2 të këtij vendimi, ujësjellës-

kanalizime sh.a. t’i marrë zyrtarisht brenda 7 (shtatë) ditëve të para të muajit nga bashkia e zonës së shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., në bazë të të cilave të bëhen lidhja e kontratës dhe vendosja e matësve, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi.

6. Listat e kategorive të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 2 të këtij vendimi, çdo bashki do t’i marrë zyrtarisht brenda 7 (shtatë) ditëve të para të muajit nga agjencitë e sigurimeve shoqërore dhe do t’i vendosë në dispozicion të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., në bazë të të cilave do të bëhet lidhja e kontratës dhe e vendosjes së matësve, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi.

7. Kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, deklarojnë pranë ujësjellës-kanalizimeve sh.a., se nuk disponojnë një kontratë të lidhur dhe/ose nuk janë të pajisur me matës në banesë dhe kërkojnë të pajisen me to. Ujësjellës-kanalizime sh.a., kryen verifikimet përkatëse me listën që disponon të abonentëve ekzistues.

8. Subvencionimi i ujësjellës-kanalizimeve sh.a., të mbulohet nga bashkia përkatëse, në përputhje me dokumentacionin që vërteton kontratën e lidhur dhe matësit e vendosur për kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi “Furnizim me ujë dhe kanalizime”, zëri “subvencione”.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkitë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe ujësjellës-kanalizime sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 34, datë 24.1.2018**

**PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT
PËR VITIN 2018 NË INSTITUCIONET E
ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË
TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2018 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, është gjithsej 1073, i ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- | | |
|---|-----|
| a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues | 20 |
| b) Për kategorinë e mesme drejtuese | 83 |
| c) Për kategorinë e ulët drejtuese | 305 |
| ç) Për kategorinë ekzekutive | 665 |

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive, janë si më poshtë:

- Shkenca juridike;
- Shkenca kompjuterike;
- Auditimi i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të

përshtatshme;

- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;

- Arsimit i lartë ushtarak/policor;
- Arsimit i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2018, janë sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Senida Mesi****Lidhja nr. 1**

**LISTA E INSTITUCIONEVE TË
ADMINISTRATËS SHTETËRORE KU
PLANIFIKOHEN VENDET VAKANTE
GJATË VITIT 2018**

1. Kryeministria dhe institucionet e saj të varësishë
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme
4. Ministria e Mbrojtjes
5. Sistemi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
6. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë
7. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
8. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
9. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit
10. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
11. Sistemi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
12. Ministria e Kulturës

**VENDIM****Nr. 35, datë 24.1.2018**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR LICENCIMIN E ARKIVAVE
PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 5, pika 3, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për licencimin e arkivave privatë”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Këshilli i Lartë i Arkivave dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi**

RREGULLORE**PËR LICENCIMIN E ARKIVAVE PRIVATË****KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Objekti dhe fusha e veprimit**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i dokumentacionit, afatit të procedurave, institucionit përgjegjës për vendimmarrjen, afateve të vlefshmërisë së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së arkivave privatë, si dhe përcaktimi i institucionit përgjegjës për inspektimin, pezullimin e revokimin, shkaqet e pezullimit të revokimit të licencës dhe përcaktimi i mënyrës së ushtrimit të së drejtës së ankimit për veprimet dhe/ose mosveprimet e institucionit përgjegjës për vendimmarrjen/pezullimin/revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së arkivave privatë.

2. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e arkivave privatë, detyrohen të pajisen me licencën “Arkiv privat”, me kodin VI.1.A.

Neni 2**Përkufizimi i termave**

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arkiv privat”, personi juridik ose fizik, pjesë e rjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë, i cili është pajisur me licencën “Arkiv privat”, me kodin VI.1.A., dhe që administron, përpunon, ruan e shërben dokumente me prejardhje joshtetërore; si dhe dokumentacion të institucioneve shtetërore, për periudhën përpara plotësimit të afateve të përcaktuara për dorëzimin në arkivin e përhershëm, sipas ligjit “Për arkivat”;

2. “Ruajtje e dokumenteve”, plotësimi i kërkesave teknike dhe teknologjike për mbrojtjen fizike të dokumenteve;

3. “Shërbim i dokumenteve”, veprimtaria që ka të bëjë me komunikimin dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore;

4. “Përpunim i dokumenteve”, grupimi tekniko-shkencor i dokumenteve, sipas kriterëve arkivore;

5. “Digjitalizim i dokumenteve”, procesi i kalimit të dokumentit nga bartës material në dokument në formë elektronike, duke ruajtur njëshmërinë me origjinalin;

6. “Licencë”, akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të;

7. “Titullar i licencës”, personi juridik ose fizik, që ka marrë një licencë.

KREU II**DOKUMENTACIONI, PROCEDURAT DHE AFATET E VLEFSHMËRISË SË LICENCËS****Neni 3****Kriteret e përgjithshme të licencimit**

Kriteret e përgjithshme të licencimit janë ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4**Kriteret teknike për licencimin e arkivit privat**

Kriteret teknike për licencimin e arkivit privat, përveç kriterëve që parashikohen në nenin 3, janë:

1. Të ketë siguruar një ndërtesë shumë-funksionale, që të plotësojë këto kërkesa:



a) Të ketë sipërfaqe vendruajtjeje të dokumenteve prej jo më pak se 500 m²;

b) Vendruajtjet e dokumenteve të jenë të ndara nga zyrat e punës;

c) Vendruajtjet e dokumenteve të kenë sistem ajrimi dhe kondicionimi, të cilat mundësojnë mbajtjen konstante të temperaturës e të lagështisë relative të ajrit, brenda kufijve 14–18° C (± 2) të temperaturës dhe 50–60 % (± 5) të lagështisë;

ç) Ndriçimi të jetë 50 lux, i vendosur paralelisht me raftet e, ndërmjet tyre dhe komanduesit të jenë jashtë mjedisve të ruajtjes, në korridor;

d) Çdo sallë e vendruajtjes të jetë e pajisur me aparat matës të lagështisë dhe temperaturës;

dh) Kapaciteti mbajtës i dyshemesë, në rast se godina është më shumë se njëkatëshe, të jetë 1 200 kg/m², për rafte fikse, dhe 1 700 kg/m², për rafte lëvizëse;

e) Sallat të jenë të pajisura me rafte metalike, çdo nivel me lartësi 30 cm dhe thellësi 80 cm (për t'u shfrytëzuar nga të dyja anët), me largësi 40–60 cm nga muri dhe 80 cm nga njëri-tjetri, ndërsa rrugicat kryesore të jenë 100–120 cm. Niveli i parë dhe i fundit i rafteve të jetë 20 cm mbi dysheme dhe nën tavan;

ë) Sallat të jenë të pajisura me sistem sinjalizues, të përbërë nga impiante të zbulimit dhe të fikjes së zjarrit, sipas normave ndërkombëtare NFPA, me fikëse zjarri me përdorimin e pudrave polivalente për shuarjen e zjarrit të mundshëm në dokumente dhe me dyoksid karboni për shuarjen e zjarrit të mundshëm në rrjetin elektrik dhe hidrante, kryesisht për shuarjen e zjarrit të mundshëm në mjediset e jashtme.

2. Të ketë burime njerëzore të mjaftueshme, si më poshtë vijon:

a) Një drejtues teknik me gradë shkencore ose master në arkivistikë dhe, së paku, tre vjet eksperiencë pune në fushën arkivore;

b) Së paku, dy punonjës për përpunimin e dokumentacionit. Punonjësit të kenë kryer master në arkivistikë ose në shkencat shoqërore dhe trajnime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

3. Të marrë përsipër të përpilojë, çdo fundvit, listën e veçimit për dokumentet me ruajtje të përkohshme, që kanë plotësuar afatin e ruajtjes, dhe t'i propozojë për miratim në komisionin e ekspertizës së institucionit, në rastet kur kontraktues është një institucion shtetëror.

4. Të marrë përsipër dorëzimin në arkivin e përhershme të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e dorëzimit, sipas ligjit, dhe të plotësojë inventarin e tyre sipas formës së përcaktuar nga arkivi i përhershëm, në rastet kur kontraktues është një institucion shtetëror.

5. Të kryejë asgjësimin e dokumenteve, pas miratimit nga komisioni epror përkatës i ekspertizës, sipas rregullave në fuqi.

6. Të marrë përsipër që të krijojë kapacitete të mjaftueshme për vendruajtje dhe punonjës për përpunim për çdo kontratë të re.

7. Në rastet kur kontraktohet për digjitalizimin e dokumentacionit arkivor, të ketë një sistem të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të përputhshëm me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për dokumentin elektronik, dhe të marrë përsipër migrimin e të dhënave të digjitalizuara në sistemin e përdorur nga arkivi përkatës i përhershëm, në rastet kur kontraktues është një institucion shtetëror.

Neni 5

Kërkesa për licencim dhe dokumentet shoqëruese

1. Kërkesa për licencimin e arkivit privat dhe dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Në dokumentet shoqëruese standarde përfshihen:

a) Akti i regjistrimit të subjektit, sipas legjislacionit në fuqi;

b) Dokumenti i identifikimit, i njohur nga ligji, i personit që paraqet kërkesën në emër të subjektit;

c) Autorizimi që vërteton se personi, i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të kërkuar licencën dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit;

ç) Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë apo të përdorimit të objektit arkivor për jo më pak se 3 vjet;

d) Raport nga projektuesi dhe inxhinieri i licencuar, që vërteton se ndërtesa që do të përdoret për qëllimet e veprimtarisë së licencimit i plotëson kushtet e pikës 1, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, duke detajuar secilën prej shkronjave të saj, shoqëruar me planvendosjen e vendruajtjeve e të rafteve në të, dhe vërtetimin nga shërbimi i zjarrfikësës për masat e mbrojtjes nga zjarri;



dh) Kontratën e punës, kopjen e kartës së identitetit, CV-në, diplomat universitare dhe vërtetimin e përvojës në punën arkivore të drejtuesit teknik;

e) Kontratën e punës, kopjen e kartës së identitetit, CV-në, diplomat universitare dhe certifikatën e trajnimit, sipas rastit, për së paku, dy punonjës;

ë) Deklaratën noteriale, sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Procedura e licencimit

1. Pas marrjes së kërkesës për licencim, Qendra Kombëtare e Biznesit shqyrton dokumentet e përcaktuara në këtë rregullore, sipas legjislacionit në fuqi për licencat dhe autorizimet.

2. Në qoftë se dokumentacioni i paraqitur rezulton i rregullt, Qendra Kombëtare e Biznesit njofton, në rrugë elektronike, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për të vlerësuar përmbushjen e kriterëve të licencimit të vendruajtjes.

3. Struktura përgjegjëse e inspektimit pranë DPA-së inspekton vendruajtjen arkivore dhe vërteton plotësimin ose jo të kriterëve, sipas pikës 1, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

4. Jo më vonë se 3 muaj, pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit, struktura përgjegjëse e inspektimit pranë DPA-së i dorëzon drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave raportin përfundimtar për licencimin e tij.

5. Në bazë të këtij raporti, drejtori i Përgjithshëm paraqet për shqyrtim kërkesën për licencim të subjektit në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Arkivave, së bashku me rekomandimin e tij.

6. Këshilli i Lartë i Arkivave vendos, me shumicë votash, për dhënien ose jo të licencës, vetëm duke u bazuar në faktin e përmbushjes apo mospërmbushjes së kriterëve të licencimit nga subjekti që ka paraqitur kërkesën.

7. Licenca “Arkiv privat” hyn në fuqi menjëherë, është pa afat dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

8. Titulli i licencës lëshohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas formatit të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

9. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit vlerësohet si miratim në heshtje.

KREU III

SHKAQET E PEZULLIMIT DHE TË REVOKIMIT TË LICENCËS

Neni 7

Procedura e inspektimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave inspekton arkivin privat, së paku, një herë në vit ose sa herë që kërkohet nga subjektet e kontraktuara prej arkivit privat.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave inspekton:

a) plotësimin e kriterëve të dhënies së licencës;

b) plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-shkencore dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 8

Pezullimi i licencës

1. Nëse struktura përgjegjëse e inspektimit pranë DPA-së vëren mospërmbushje të kriterëve të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 7, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave pezullon licencën dhe urdhëron përmbushjen e detyrimeve nga ana e subjektit të licencuar brenda një afati 30-ditor.

2. Gjatë periudhës së pezullimit të licencës, arkivi privat nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me institucione të tjera. Ai vijon ecurinë e detyrave të tjera funksionale deri në përmbushjen e tyre.

3. Pas afatit të përcaktuar për përmbushjen e detyrimeve, struktura përgjegjëse e inspektimit pranë DPA-së, brenda 5 ditëve, bën verifikimin në terren dhe njofton në shkallë hierarkike për konstatimet e bëra.

4. Vendimi i pezullimit të licencës publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

5. Urdhri i pezullimit revokohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet.



Neni 9

Revokimi i licencës

1. Në rast të mospërbushjes së përsëritur të detyrimeve të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 7, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Lartë të Arkivave dhe paraqet raportin e inspektimit.

2. Këshilli i Lartë i Arkivave vendos, me shumicë votash, një nga sanksionet, si më poshtë vijon:

a) Shtyrjen, me 30 ditë të tjera, të përbushjes së detyrimeve të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje;

b) Revokimin e licencës, nëse vlerësohet se përbushen kushtet e pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 10081/2009, “Për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”.

3. Revokimi i licencës hyn në fuqi menjëherë me miratimin dhe publikimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Lejeve, Licencave dhe Autorizimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, ndërkohë që subjekti privat shkarkohet nga detyrimet ligjore e kontraktuese vetëm pas përbushjes të të gjitha detyrimeve me palët kontraktuese.

Neni 10

Njoftimi i pezullimit/revokimit dhe ankimimi

1. Çdo vendim për miratimin e refuzimin e një kërke, si dhe çdo vendim për pezullimin e revokimin e licencës duhet të publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet drejtpërdrejt ndaj veprimeve apo mosveprimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Këshillit të Lartë të Arkivave në gjykatë, brenda afateve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

KREU IV

SANKSIONE DHE DISPOZITA KALIMTARE

Neni 11

Sanksione ligjore

1. Nëse struktura përgjegjëse e inspektimit pranë DPA-së vëren mospërbushje të kriterëve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenin

7, zbatohen sanksionet e përcaktuara në nenin 92, të ligjit “Për arkivat”, sipas procedurave standarde të inspektimit.

2. Masa e pezullimit të licencës mund të shoqërohet edhe nga sanksionet e parashikuara në ligjin “Për arkivat”, në rastet kur shkelja e konstatuar përbush kriteret e të dyja masave njëkohësisht.

Neni 12

Tarifat

Arkivat privatë përdorin tarifat e shërbimit të dokumenteve sipas nenit 77, të ligjit “Për arkivat”.

Neni 13

Institucionet zbatuese

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Këshilli i Lartë i Arkivave dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e kësaj rregulloreje.

SHTOJCA 1

DEKLARATË NOTERIALE

Deklarata noteriale, e përpiluar sipas legjislacionit në fuqi, duhet të përmbajë:

(Emri i subjektit) _____, me NIPT: _____, më poshtë “Arkiv privat”, deklaron me përgjegjësi të plotë se për çdo marrëdhënie të re kontraktuale do të sigurojë hapësirën e nevojshme të vendruajtjes, sipas standardeve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për shërbimin arkivor, të barabartë me $[1.2/(\text{numrin e kateve të rafteve}) \times X (\text{sasinë në metra linearë të kontraktuar})] \text{ m}^2$, si dhe, së paku, një punonjës për përpunimin e dokumentacionit, që plotëson kriteret ligjore, për çdo 10 metra linearë dokumentacion të kontraktuar për përpunim, për një vit. Për çdo kontratë të re do të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, së bashku me dokumentacionin që vërteton plotësimin e këtij detyrimi.

Deklaron se, në rastet kur subjekti kontraktues është institucion shtetëror, përpara datës 15 dhjetor të çdo viti do të përgatitet lista e veçimit për dokumentet me ruajtje të përkohshme, që kanë plotësuar afatin e ruajtjes; do t’i propozohet, për miratim, komisionit të ekspertizës së institucionit kontraktues; dhe do të dorëzojë në arkivin e përhershëm përkatës, sipas ligjit “Për arkivat”,



dokumentacionin me rëndësi historike kombëtare, që ka plotësuar afatin e dorëzimit, në mënyrën e parashikuar në normat tekniko-profesionale të Republikës së Shqipërisë, dhe do të plotësojë inventarin e tyre, sipas formës së kërkuar nga arkivi përkatës i përhershëm.

Deklaron se merr përsipër të asgjësojë dokumentacionin brenda 30 ditëve, pas çdo vendimi të komisionit epror të ekspertizës për miratimin e asgjësimit të dokumenteve që janë në ruajtje pranë arkivit privat, në një nga dy format e parashikuara nga ligji, nën mbikëqyrjen e një komisioni të përbërë nga institucioni kontraktues, arkivi privat dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, me kostot e mbuluara nga arkivi privat.

Deklaron se merr përsipër të sigurojë një sistem të certifikuar të menaxhimit të dokumentit elektronik nga organet kompetente, në rastet kur objekt i kontraktimit është edhe digjitalizimi i dokumenteve, si edhe në rastet kur subjekti kontraktues është institucion shtetëror, të migrojë të dhënat e digjitalizuara në sistemin e përdorur nga arkivi përkatës i përhershëm, sapo të dorëzohet dokumentacioni shkresor.

Deklaron se është në dijeni që mosplotësimi i detyrimeve që burojnë nga kjo deklaratë përbën shkak për pezullimin dhe/ose revokimin e licencës, si dhe për vendosjen e sanksioneve ligjore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

VENDIM

Nr. 36, datë 24.1.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 673, DATË 22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RIORGANIZIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën nr. 2, kolona “Sistemi/infrastruktura”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, emërtesat “Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS)” dhe “Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS) në gjykatat administrative” hiqen.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 38, datë 24.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 413, DATË 25.6.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË SHITJES SË TROJEVE NË PËRDORIM, SIPËRFAQE TË DOMOSDOSHME DHE TROJEVE SHITESË FUNKSIONALE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE TREGTARE, TË OBJEKTEVE SHTETËRORE TË VEÇUARA, TË PRIVATIZUARA, TË OBJEKTEVE APO NDËRTESAVE TË SHITURA TË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE, SI DHE TË NDËRTESAVE TË NDËRTUARA NË BAZË TË LEJEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, të ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.9.1995, “Për shitblerjen e



trojeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 413, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Shitja e truallit të pashitur, sipërfaqe e domosdoshme, e ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore, të privatizuara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, degët e saj në rrethe, nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, me degët e saj në rrethe, si dhe trojet e objekteve apo ndërtesave të shitura, pronë e ish-kooperativave bujqësore, të bëhet, në përputhje me këtë vendim nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas genplanit dhe dokumentacionit në momentin e privatizimit të tyre. Kjo drejtori kryen edhe shitjen e trojeve të ndërmarrjeve e të objekteve të tjera shtetërore, të privatizuara para krijimit të këtyre agjencive, si dhe të truallit të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, sipas genplaneve dhe dokumentacionit në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit, në të cilin janë përcaktuar objektë apo sheshi i ndërtimit.

3. Personi fizik apo juridik privat, i cili do të blejë truallin e ndërmarrjes ose të objekteve, sipas përcaktimit në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën, me shkrim, për blerje të truallit;

b) Kartelën e pasurisë apo certifikatën e pronësisë të noterizuar, nëse e ka, së bashku me hartën treguese për objektin apo objektet që ka në pronësi, të lëshuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

c) Kopjen e noterizuar të kontratës së privatizimit të objektit, të ndërmarrjes, së bashku me genplanin në momentin e privatizimit apo kopjen e noterizuar të lejes së ndërtimit, së bashku me genplanin e miratuar sipas lejes së ndërtimit, për rastet e objekteve të ndërtuara në bazë të lejeve të

Faqe | 120

ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim;

ç) Mandatin e arkëtimit për pagesën e taksës së përdorimit të truallit, nga data 7.6.2010 deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për blerjen e truallit.”

b) Në pikën 4, fjalët “... dhe zyrës përkatëse vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ...” dhe “... dhe hartën treguese me të dhënat e nevojshme gjeografike për zonën përkatëse ...,” hiqen.

c) Në pikën 5, fjalia “Ndërsa, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, i përcjellin kësaj drejtorie hartën treguese përkatëse, me të dhënat e nevojshme gjeografike dhe statusin e truallit që kërkohet të privatizohet” shfuqizohet.

ç) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5.1. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, merr informacionin e nevojshëm për statusin juridik të pasurisë që kërkohet të privatizohet, nëpërmjet sistemit digjital (në formë elektronike) të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në rastet kur e gjykon të arsyeshme, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i kërkon, me shkrim, zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme informacion apo dokumentacion në lidhje me objektin apo objektet që kërkuesi ka në pronësi, si dhe statusin e truallit që kërkohet të privatizohet.”

2. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat, e mëposhtme:

a) Pikat 1, 2 e 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Me “sipërfaqe shtesë funksionale”, nënkuptohet sipërfaqja që kërkohet nga pronarët e ndërmarrjeve, të objekteve të privatizuara dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, për zgjerim, shërbime apo ristrukturim të veprimtarisë.

2. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kryen procedurën e shitjes së sipërfaqeve shtesë funksionale të objekteve, sipas përcaktimit në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, duke përfshirë edhe



objektet e privatizuara nga kjo drejtori.

3. Kërkesa për kryerjen e kësaj procedure paraqitet nga kërkuesit pranë Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me genplanin e sipërfaqes së kërkuar për t'u blerë, të përgatitur nga ekspertë të licencuar, si dhe dokumentacionin sipas përcaktimit në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi, (përfshijtur mandatarëtimin për pagesën e taksës së truallit)."

b) Në pikën 4, fjalët "... dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ...", "... dhe statusin e truallit në zonën përkatëse.", "... dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ..." dhe fjalja "Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme konfirmon statusin juridik të truallit dhe hartën treguese me të dhënat e nevojshme gjeografike." hiqen.

c) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

"5.1 Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, merr informacionin e nevojshëm për statusin e truallit që kërkohet të privatizohet, nëpërmjet sistemit digjital (në formë elektronike) të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në rastet kur e gjykon të arsyeshme, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i kërkon, me shkrim, zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme informacion apo dokumentacion në lidhje me objektin apo objektet që kërkuesi ka në pronësi, si dhe statusin e truallit që kërkohet të privatizohet."

3. Kudo në këtë vendim, emërtimet "Ministria e Financave" dhe "Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" zëvendësohen, përkatësisht, me "Ministria e Financave dhe Ekonomisë" dhe "Agjencia e Trajtimit të Pronave".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 39, datë 24.1.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 378, DATË 26.4.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
"PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN I
BLOKUT TË KUFIZUAR NGA RRUGËT:
"SULEJMAN DELVINA", "MEDAR
SHTYLLA", "SKËNDER LUARASI",
"GRIGOR HEBA" DHE "GJIK KUQALI",
TIRANË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 378, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, për pasuritë që preken nga projekti "Rikualifikimi urban i bllokut të kufizuar nga rrugët "Sulejman Delvina", "Medar Shtylla", "Skënder Luarasi", "Grigor Heba" dhe "Gjik Kuqali", Tiranë", hiqet pasuria shtet, me numër rendor 15, zona kadastrale 8270, me numër pasurie 6/458.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI “PËR RIKUALIFIKIM URBAN TË BLOKUT TË KUFIZUAR NGA RRUGËT: “SULEJMAN DELVINA”, “MEDAR SHTYLLA”, “SKËNDER LUARASI”, “GRIGOR HEBA”, “GJIK KUQALI””
(FAZA E PARË)

Nr.	Emër, atësia, mbiemër	ZK	Nr. pas.	Sip. e përgj. truall m ²	Sip. e prekur truall m ²	Çmimi për truall lekë/m ² .	Objekti, sip. e përgj. m ²	Objekti, sipërfaqja preket m ²	Çmimi për objekt lekë/m ²	Vlera (truall i prekur) lekë	Vlera (objekt i prekur) lekë	Vlera (truall + objekt) lekë	KONFIRMIM, ZVRPP TIRANË
1	Bashkëpronarët Kika, Pleshiti, Verzivolli	8260	6/340	1045	403	30783				12405549	0	12405549	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
2	Shtet	8260	6/67	50.35	29	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
3	Shtet	8260	6/537	284.3	134	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
4	Bashkëpronarët: Papa, Buda, Xheka, Stasoli, Kostandini, Kumani, Kisi, Tona, Panajoti, Kasimati, Gero, Basko, Leka, Kristuli, Bele, Jançe, Tiço, Poda, Prifti, Tasi	8260	4/430	737	90	30783				2770470	0	2770470	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
5	Shtet	8260	6/517	2618.18	990	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
6	Bashkëpronarët: Gama, Pinari, Kalem, Kukaleshi, Kusi, Kristani	8260	6/282	416	416	30783				12805728	0	12805728	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
7	Shtet	8260	6/641	1171.09	3.6	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
8	Shtet	8260	6/68	127.47	127.47	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
9	Fatmira Sinani	8260	6/68/ND	0	0	0	127	127	103254	0	13113258	13113258	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/3, datë 30.6.2016
10	Erion Stilian Thomai	8260	6/283	600	91	30783				2801253	0	2801253	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
11	“Haxhiu” sh.p.k.	8260	6/675	3114	0	0				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
12	“Haxhiu” sh.p.k.	8260	6/676	1872	0	0				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
13	Bashkëpronarët: Kika, Vorpsi, Pleshiti, Verzivolli	8260	6/344	420	353	30783				10854086	0	10854086	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
14	Flutura Qazim Verzivolli	8260	6/354	662	129	30783				3971007	0	3971007	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
15	Mynyvere Neim Spaho	8270	6/102	640	61	66969				4085109	0	4085109	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
16	Shtet	8270	6/2	503	281	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
17	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8270	6/356	380	127	66969				8511760	0	8511760	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
18	Bashkëpronarët Kasmi	8270	6/233	69	0	0				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
19	Shtet	8270	6/443	141	52.5	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
20	Shtet	8260	4/118	1421	1376	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
21	Shtet	8270	6/116	87	31.5	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
22	Shtet	8270	8/648	384	12.5	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
23	Bahri Osman Pinari	8270	6/318	140	3.5	66969				234392	0	234392	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
24	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe,	8260	4/437	107.2	7	30783				215481	0	215481	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016



	Bele, Tiço, Gero, Kasimati												
25	Mynevere Neim Spaho	8260	4/113	390	162	30783				4986846	0	4986846	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
26	Bashkëpronarët: Dimitresku e Santo	8260	4/111	124	18	30783				554094	0	554094	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
27	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8260	4/435	379.5	92	30783				2832036	0	2832036	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
28	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8260	4/436	317.8	148	30783				4555884	0	4555884	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
29	Bashkëpronarët: Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Tase, Pambuku, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Spaho, Kristuli, Bele	8260	4/384	90	47	30783				1446801	0	1446801	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
30	Shtet	8260	4/610	232.86	212	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
31	Shtet	8260	4/253	568.65	564	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
32	Nezir Alla	8260	4/253/ND		0	0	167.7	167.7	67749.74	0	11361631	11361631	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/3, datë 30.6.2016
33	Ardian Dashi	8260	4/251/ND		0	0	94.4	94.4	103254	0	9747178	9747178	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/3, datë 30.6.2016
34	Bashkëpronarët: Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Prifti, Tase, Vodo, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Dervishi, Tiço, Xheka, Stastoli	8260	4/387	175	34	30783				1046622	0	1046622	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
35	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8260	4/444	149	29	30783				892707	0	892707	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
36	Bashkëpronarët: Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Prifti, Tase, Vodo, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Dervishi, Tiço, Xheka, Stastoli	8260	4/386	140	10	30783				307830	0	307830	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
37	Bashkëpronarët: Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Prifti, Tase, Vodo, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Dervishi, Tiço, Xheka, Stastoli	8260	4/388	130	10	30783				307830	0	307830	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016



38	Frensis Shkëlqim Spaho, Elvana Stefan Spaho	8260	4/540	598.02	5	30783				153915	0	153915	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
39	Shtet	8260	4/254	109.4	105	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
40	Pasuria e pozicionuar në hartë ndërmjet pas. nr. 6/233 ZK 8270 dhe pas. nr. 6/469 ZK 8270	8270			20	66969				1339380	0	1339380	Në shkresën e ZVRPP-së është shënimi pa informacion
41	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8270	6/360	599	33	66969				2209977	0	2209977	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
42	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8270	6/358	83.4	17	66969				1138473	0	1138473	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
43	Bashkëpronarët: Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8270	6/357	33.6	8	66969				535752	0	535752	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
44	Shtet	8270	6/441	216	187	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP, me shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.3.2016
SHUMA					6418.77				389.1	80,962,981.2	34,222,067	115,185,048	

**VENDIM****Nr. 40, datë 24.1.2018****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 803, DATË 29.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KOMPENSIMIN E FAMILJEVE TË FSHATRAVE ZALL-MËNER DHE BULÇESH, KOMUNA ZALL-BASTAR, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 803, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Vlera e përgjithshme e kompensimit, prej 82 611 200 (tetëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM**Nr. 41, datë 24.1.2018****PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Diplomë”, dokumenti zyrtar që i jepet studentit në përfundim të programit të studimit, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të;

b) “Grup-lëndë”, një strukturë akademike dhe administrative organizimi brenda një departamenti, e cila grupon anëtarë të stafit akademik që mbulojnë lëndë të përafërta brenda një fushe të ngjashme studimi;

c) “IAL”, institucion i arsimit të lartë;

ç) “Komponent mësimor”, veprimtari e strukturuar dhe formale mësimore;

d) “Laborator”, veprimtaria formuese akademike, gjatë së cilës studenti përvetëson dhe provon aftësitë e tij për të eksperimentuar, investiguar, observuar dhe provuar teori e metoda të caktuara, të planifikuara brenda një lënde të caktuar, e cila mund të vlerësohet me notë dhe me kredite;

dh) “Lëndë”, një degë e një fushe shkencore, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë sistematike gjatë një kohe të caktuar;

e) “Lëndë individuale artistike”, një degë në fushën e arteve, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë individuale;

ë) “Modul”, një pjesë e programit të lëndës, i cili përmbledh në mënyrë të logjikshme, të vazhduar, të rregullt dhe të organizuar tematika të ngjashme, që ndërtohet mbi një numër të kufizuar objektivash mësimorë – akademike që pritet të realizohen nga studenti;



f) “Praktikë”, një veprimtari formuese akademike, që vlerësohet me vlerësim pozitiv ose edhe me notë kaluese e me kredite, gjatë së cilës studentit i kërkohet të zgjerojë dhe të aplikojë njohuritë e marra në auditor, për të fituar aftësi shtesë brenda një mjedisi praktik profesional ose artistik, në kuadër të një programi të caktuar studimi, duke plotësuar kërkesa dhe standarde të njohura etike, profesionale e ligjore;

g) “Profil i programit të studimit”, një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore-shkencore brenda një programi studimi, përfundimi me sukses i të cilave e pajis studentin me emërtimin e profilit përkatës brenda diplomës që ofron institucioni i arsimit të lartë;

gj) “Provim i përgjithshëm përfundimtar”, një detyrim akademik, përmbledhës i një cikli studimi “Bachelor” ose “Master profesional”, pas kalimit me sukses të të cilit studenti pajiset me diplomën përkatëse;

h) “Objektiva formues dhe kompetenca profesionale”, bashkësia e dijeve, aftësive e kompetencave specifike të fushës, që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit.

2. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:

a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);

b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;

c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;

ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;

d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;

dh) planin mësimor;

e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;

ë) programin lëndor (*Syllabus-et*);

f) profilin e programit;

g) diplomën dhe suplementin.

2.1 Kreditet sipas ECTS-së

a) Krediti i formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.

b) Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.

c) Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.

ç) Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.

d) Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe.

dh) Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).

e) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtën IAL, si dhe në të njëjtën apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.

ë) IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kriterëve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.

2.2 Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit

a) Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave.

b) Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e



objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studenti.

c) Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritët të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale.

ç) Metodatat e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit.

2.3 Objektivat formues dhe kompetencat profesionale.

a) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale në një program studimi përcaktojnë formimin, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që përfiton studenti deri në përfundim të programit të studimit.

b) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale:

i) i atribuohen komponentëve të veçantë mësimorë, si dhe programit të studimit në tërësi;

ii) përcaktohen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përshkrimit të kualifikimeve individuale, për sa u përket njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara me përfundimin e studimeve.

iii) vlerësohen nëpërmjet procedurave të bazuara në kritere të qarta e transparente.

c) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale ndahen në:

i) përcaktues/e, të cilët/të cilat janë të njëjtë/a për programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruar nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë.

ii) specifikë/e, të cilët/ të cilat diferencojnë programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruara nga IAL të ndryshme. Këta/o objektiva e kompetenca përcaktohen veçmas nga secili institucion ofrues i programit të studimi.

2.4 Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit.

a) Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:

i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;

ii) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh;

iii) përgatitje për provime;

iv) përgatitje e tezës së diplomës;

v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.

b) Ndajja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë.

c) Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u përlogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

2.5 Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi.

a) Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS.

b) Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;

ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;

iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;

iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikatat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;

v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.

Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet në shtojcën nr. 1, tabela 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Veprimtaritë formuese mund të jenë:

i) të detyrueshme;

ii) të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni, dhe koherente me



programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit.

2.6 Plani mësimor

Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:

i) lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra;

ii) kreditet përkatëse.

2.7 Kuotat e pranimi dhe grupet mësimore

a) IAL-të përcaktojnë kuotat e lira për regjistrimet e reja të studentëve për çdo program studimi në përputhje me standardet e përcaktuara për raportin personel akademik me kohë të plotë për studentë dhe normativën e përcaktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme për student, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”. Kuotat e pranimi llogariten mbi bazën e studentëve aktivë, që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

b) Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet nga IAL-të në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore.

c) Kuotat në dispozicion për transferimin e studentëve nga IAL të tjera ose brenda së njëjtës IAL përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik. Transferimet pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së pestë të semestrit të parë.

ç) Kuotat në dispozicion të transferimeve mund të shfrytëzohen edhe nga studentë, të cilët ndërpresin studimet në një program për t'u regjistruar në një program të të njëjtit cikël studimi, që i përket një fushe të ndryshme studimesh nga ajo e mëparshme, nëse numri i krediteve, që njihen nga IAL-ja pritëse, është i mjaftueshëm për t'u regjistruar në vitin e dytë të studimeve.

d) Numri i studentëve, që përmban grupi mësimor sipas fushës së programit të studimit, përcaktohet në shtojcën nr. 1, tabela nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.8 Programi lëndor (*syllabus*-et).

Modeli i programit të lëndës, që do të përdoret për hartimin e *syllabus*-eve, duhet të përmbajë elementet sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.9 Profili i programit

a) Programi i studimit mund të organizohet në profile, të cilat ofrojnë specializime në drejtime të ngushta të fushës së programit të studimit, në fusha integruuese ose ndërdisiplinore të përafërta.

b) Emërtimi i profilit të programit të studimit shënohet në diplomën, që lëshohet në përfundim të tij.

c) Me vendim të Senatit Akademik, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të bëjë ndryshime të profileve (të hapë, të mbyllë ose të riorganizojë) brenda programit të studimit. IAL-ja njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin, jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik, për ndryshimet deri në masën 20 për qind të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS.

2.10 Diploma dhe suplementi

a) Diplomat, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë, si dhe ato të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, shoqërohen me suplementin e diplomës.

b) Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe përshkruan natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



SHTOJCA NR. 1

Tabela nr. 1

Veprimtaritë formuese përcaktohen në tabelën e mëposhtme:

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Cikli i parë	Cikli i dytë		
			Master profesional	Master i shkencave/ master i arteve	Master i shkencave (i integruar)
A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15% - 20% (kredite)	5%-10% (kredite)	5%-10% (kredite)	15% - 20% (kredite)
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disipinën shkencore	50% - 55% (kredite)	30% - 40% (kredite)	50% - 60% (kredite)	45% - 55% (kredite)
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12% -15% (kredite)	20%-30% (kredite)	12% -20% (kredite)	12% -15% (kredite)
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15% (kredite)	10% (kredite)	10% (kredite)	6 – 8 % (kredite)
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%-5% (kredite)	10%- 20% (kredite)	10-15% (kredite)	3%-5% (kredite)

Shënim. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve “Bachelor” e “Master i shkencave i integruar”, dhe jo më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”. Në rastin e “Master i arteve” ky raport vendoset sipas specifikave të vetë programit të studimit.

TABELA NR. 2
GRUPIMET MËSIMORE

Grupet mësimore në programet e studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë të organizohen me numër studentësh, si më poshtë:

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ seminar	Nr. i studentëve/ laborator	Nr. i studentëve/ praktika	Nr. i studentëve/ leksion
Shkenca natyrore	35	25	25	6 grupe seminari
Inxhinieri dhe teknologji	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca mjekësore dhe shëndetit	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca agrikuturore dhe veterinarisë	35	25	25	6 grupe seminari
Shkenca sociale	35	25	25	6 grupe seminari
Humanitete dhe arte	35	25	25	6 grupe seminari

PËR UNIVERSITETIN E ARTEVE
(BAZUAR NË SPECIFIKAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE MËNYRËS SË MËSIMDHËNIES)

Fusha e studimit	Lëndë individuale artistike/ nr. i studentëve	Mësim artistik në grup/ nr. i studentëve	Nr. i studentëve/ seminar	Nr. i studentëve/ praktika/ shoqërim në piano	Nr. i studentëve/ leksion	Studentëve/ laborator
ARTET	1	1–15	1–15	1–15	1–6 grupe seminari	1–15



SHTOJCA NR. 2 PROGRAMI I LËNDËS

(Emri i lëndës)

Shënim. Të gjitha shënimet brenda kllapave, me të pjerrëta, duhet të fshihen, përfshirë këtë shënim)

Titullari /pedagogu i lëndës: *(emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshtetësi)*

Ngarkesa: *(numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)*

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/semestri kur zhvillohet:

Lloji i lëndës: *(e detyrueshme ose me zgjedhje)*

Programi i studimit: *(programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)*

Kodi i lëndës:

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT: *(Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës)*

KONCEPTET THEMELORE: *(janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda)*

- 1.
- 2.
- 3.
- ...

TEMAT E LËNDËS *shpjegimi (rreth një paragrafi) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe)*

Tema I –

Tema II –

Tema III –

.....

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:

KONTROLLI I VAZHDUESHËM: *(renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar etj.)*

LITERATURA *(literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në)*

a) Literatura bazë e detyrueshme:

b) Literatura e rekomanduar:

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS *(hapësira ku pedagogu paraqet mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka)*

**VENDIM****Nr. 42, datë 24.1.2018**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT NGA KATEGORIA “TOKË
BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”,
TRUALL, TË PASURIVE ME NUMRAT
29/6, 29/7, 29/8, 29/9, 29/10, 29/11, 29/12,
29/13, 29/14, 29/15, 29/16, 29/17, 29/18, 29/19
DHE 35/32, ZONA KADASTRALE 3365,
FSHATI SHETAJ, NJËSIA
ADMINISTRATIVE ISHËM,
BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurive me numrat 29/6, 29/7, 29/8, 29/9, 29/10, 29/11, 29/12, 29/13, 29/14, 29/15, 29/16, 29/17, 29/18, 29/19 dhe 35/32, me sipërfaqe totale prej 50 300 (pesëdhjetë mijë e treqind) m², zona kadastrale 3365, fshati Shetaj, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, sipas certifikatave të pasurisë dhe hartave treguese, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimin nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurive me numrat 29/6, 29/7, 29/8, 29/9, 29/10, 29/11, 29/12, 29/13, 29/14, 29/15, 29/16, 29/17, 29/18, 29/19 dhe 35/32, me sipërfaqe totale prej 50 300 (pesëdhjetë mijë e treqind) m², zona kadastrale 3365, fshati Shetaj, njësia administrative Ishëm, Bashkia Durrës.

3. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurive në certifikatat e pasurive, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i

Qarkut Durrës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM**Nr. 1, datë 19.1.2018**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datat 17.7.2017, 20.9.2017 dhe 21.9.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 33 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Zeqine Kokonozi, Agim Kokonozi, Mahmut Kokonozi, Sami Kokonozi, Bahri Kokonozi, Hysen Kokonozi, Pranvera Kokonozi (Saliaj), Mimoza Kokonozi, Ina Kokonozi, Aldo Kokonozi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Çlirim Kokonozi, Bujar Kokonozi, Dashnor Kokonozi, Shkëlqim Kokonozi, Dhurata Kozeli, Majlinda Cukalla, Merita Kodra, Lavdiye Kokonozi, (Çela), Engjëllushe Kokonozi (Gjoza), Luljeta Kokonozi (Topi), Ylber Kokonozi, Mimoza Kokonozi (Kote), Lejla Kokonozi (Kalaja), Njazi Dashi, Lutfi Dashi, Beniamin Dashi, Eqerem Basha, Muhamet Basha, Suzana Basha, Silvana Basha, Entela Vakiari, Eljora Basha, shoqëria “Neon” sh.p.k., Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Avokatura e Shtetit, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, Skënder Lena, Katina Imeraj, shoqëria anonime “Alpha Bank” sh.a.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 615, datë 27.2.2014. të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2016-1671, datë 25.5.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).



BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësve, që kërkuan pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara, Katina Imeraj, Skënder Lena, shoqëria “Neon” sh.p.k., me cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “Castellania” s.r.l., Avokatura e Shtetit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit dhe disa prej subjekteve të interesuara janë trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësve Selim dhe Sefer Kokonozi. Me vendimet nr. 959, datë 10.5.1996 dhe nr. 948, datë 22.4.1996 të KKKP-së Tiranë, subjekteve të interesuara u është njohur e drejta e parablerjes së objekteve mbi sipërfaqen e truallit të godinës “Fabrika e porcelanit”, në momentin e privatizimit të saj.

2. Me kontratën e shitjes së kuotave të datës 6.8.2004, shoqëria “Castellania” s.r.l. i ka shitur subjektit të interesuar shoqërisë “Neon” sh.p.k., kuotat e kapitalit themeltar prej 55,7%, duke i kaluar të gjitha të drejtat e ortakut joshtetëror në ish-ndërmarrjen e përbashkët. Subjektet e interesuara kanë pretenduar se aktet me të cilat është realizuar kalimi i pronësisë nga shteti te shoqëria “Neon” sh.p.k. janë marrë në kundërshtim me ligjin. Me kontratën e shitblerjes së datës 8.4.2005 AKP-ja ka bërë privatizimin nëpërmjet shitjes te pala e paditur “Neon” sh.p.k. të pjesëve të kapitalit themeltar të zotëruara nga shteti. Nëpërmjet kësaj kontrate shoqëria “Neon” sh.p.k. është bërë ortak i vetëm i shoqërisë “Castellania” s.r.l. Subjektet e interesuara me pretendimin se duke u lidhur kjo kontratë, u është dhënë mundësia për të ushtruar të drejtën e parablerjes, si një e drejtë reale, i janë drejtuar

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes nr. 1450 rep., nr. 110 kol., datë 8.4.2005, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke iu kthyer e drejta e kuotave zotëruese, sipërfaqet e truallit dhe objektet e ndodhura mbi të, si dhe fshirjen e pasojave përkatëse nga regjistri hipotekor nr. 23, datë 21.2.2005 i ZVRPP-së Tiranë. Konstatimin e pavlefshmërisë të kontratave të shitblerjes, përkatësisht me nr. 3110 rep., nr. 358 kol., datë 28.6.2005, nr. 3139 rep., nr. 364 kol., datë 29.6.2005 dhe nr. 3162 rep., nr. 367 kol., datë 30.6.2005, kontrata këto të lidhura respektivisht ndërmjet shoqërisë “Castellania Tiranë” sh.p.k. në likuidim e sipër dhe të paditurve Katina Imeraj, Skënder Lena dhe shoqërisë “Neon” sh.p.k., si dhe zgjidhja e pasojave juridike të ardhura nga këto kontrata, duke u fshirë nga regjistrat hipotekorë, regjistrimi hipotekor nr. 60, datë 9.9.2005, për të paditurën Katina Imeraj, regjistrimi hipotekor nr. 61, datë 9.9.2005 për të paditurin Skënder Lena, si dhe regjistrimi hipotekor nr. 62, datë 9.9.2005 për të paditurin shoqëria “Neon” sh.p.k.

3. Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2794, datë 11.4.2011 ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

4. Mbi ankimin e kërkuësve dhe të subjektit të interesuar shoqërisë anonime “Alpha Bank” sh.a., si dhe të Ministrisë së Ekonomisë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1916, datë 16.7.2012 ka vendosur prishjen e vendimit civil nr. 2794, datë 11.4.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes.

5. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë kanë ushtruar rekurs subjektet e interesuara Lavdiye Kokonozi (Cela), Luljeta Kokonozi (Topi), Ylber Kokonozi, Mimoza Kokonozi (Kote) dhe Lejla Kokonozi (Kalaja). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 416, datë 9.7.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1916, datë 16.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 615, datë 27.2.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 2794, datë 11.4.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

7. Mbi rekursin e subjekteve të interesuara, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.



00-2016–1671, datë 25.5.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

8. **Kërkuesit** i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke argumentuar si vijon:

8.1 Gjykata e Apelit Tiranë ka cenuar parimin e ligjshmërisë dhe parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi ka marrë një vendim në kundërshtim me normat për përcaktimin e saktë të mosmarrëveshjes, duke u bazuar te një vlerësim objektiv i pretendimeve të subjekteve të interesuara. Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar kërkesën për nxjerrjen jashtë kompetencës të çështjes, duke u shprehur se kundër vendimit të ndërmjetëm mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Gjithashtu, kjo gjykatë ka shkelur rregullat e formimit të ndërgjyqësish, pasi nuk ka bërë kalimin procedural dhe ka legjitimuar si palë në gjykim Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të cilat nuk ekzistojnë më me këto emërtime pas strukturës së re qeverisëse në tetor të vitit 2013, pra më shumë se 4 muaj para shqyrtimit të çështjes.

8.2 Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 615, datë 27.2.2014, nuk ka marrë parasysh detyrat e lëna nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Kjo gjykatë nuk ka hetuar dhe nuk ka argumentuar origjinën e titullit të pronësisë mbi sendin objekt gjykimi.

8.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, megjithëse në rekurs ishin parashtruar shkaqe të cilat duhet të shqyrtoheshin në seancë gjyqësore, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos e arsyetuar vendimin e tij.

9. **Subjekti i interesuar Katina Imeraj** ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

9.1 Pretendimi i kërkuesve se Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar. Gjykata e Lartë ka pasqyruar të gjitha pretendimet në vendim dhe vendimi për mospranimin e rekursit është në kompetencë të Kolegjit në dhomën e këshillimit.

9.2 Pretendimin për cenimin e parimit të ligjshmërisë kërkuesit nuk e kanë ngritur në nivelin

kushtetues kurse pretendimin për cenimin e parimit të ligjshmërisë e kanë lidhur me faktin e privatizimit të ndërmarrjes shtetërore, çështje e cila i përket shqyrtimit dhe vlerësimit nga gjykatat e zakonshme.

9.3 Pretendimi i kërkuesve se Gjykata e Apelit nuk ka zbatuar ligjin dhe nuk ka hetuar mbi të drejtën e pronësisë është i pabazuar. Kërkuesit nuk e kanë të qartë dallimin midis pronësisë së truallit si pronë e shoqërisë tregtare dhe pronësisë së ortakëve sipas kuotave në zotërim. Çdo pretendim mbi mënyrën e fitimit të pronësisë dhe privatizimit i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

9.4 Pretendimi i kërkuesve se Gjykata e Apelit Tiranë ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin duke vendosur rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen jashtë kompetence të çështjes, pasi sipas kërkuesve duhej të gjykohej nga gjykata civile, është i pabazuar. Vendimi nr. 3/2014 i Kolegjeve të Bashkuara ka përcaktuar se çështjet të cilat kanë disa kërkitime administrative dhe civile të paraqitura para datës 4.11.2013 do të vazhdojnë të gjykohen nga gjykatat ku janë paraqitur.

9.5 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në aspektin e së drejtës së pronësisë është i pabazuar. Kërkuesve u është njohur e drejta e pronësisë rreth 4 vjet pasi shoqëria “Castellania” e kishte fituar këtë të drejtë.

10. **Subjekti i interesuar Skënder Lena** ka paraqitur parashtrime me shkrim duke argumentuar si vijon:

10.1 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Gjatë procedurave të kalimit të pronësisë është realizuar balancimi ligjor midis shtetit dhe individit për mënyrën e administrimit të pronave të paluajtshme të kërkuesve. Konkretisht, në kushtet kur prona për të cilën ata janë njohur si pronarë ka qenë e zënë, me vendimin e KKKP-së është vendosur kompensimi me një tokë tjetër të lirë.

10.2 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar, pasi çdo veprim i kryer ndaj palëve gjatë gjykimit nuk ka qenë diskriminues, por është kryer në zbatim të parimit të proporcionalitetit.

11. **Subjekti i interesuar shoqëria “Neon” sh.p.k., me cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “Castellania” s.r.l.,** ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:



11.1 Pretendimet e parashtruara nga kërkuesit nuk janë ngritur në nivel kushtetues e, si rrjedhojë janë të pabazuara.

11.2 Gjatë gjykimit të çështjes është provuar se padia e kërkuesve ka qenë pa shkak procedural, pasi prona “Fabrika e porcelanit” nuk u është nënshtruar procedurave të privatizimit, e për rrjedhojë kërkuesit nuk legjitimohen në paraqitjen e kërkesës.

11.3 Kontrata objekt gjykimi ka pasur si objekt transferimin e kuotave midis ortakëve të shoqërisë “Castellania” s.r.l. dhe jo shitjen e pasurisë të shtetit shqiptar. Në këto kushte kërkuesve nuk u është cenuar asnjë e drejtë kushtetuese.

11.4 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të ligjshmërisë është i pabazuar dhe pa referencë në ligjin kushtetues. Ky pretendim bie në kundërshtim me nenin 42/2 të Kushtetutës dhe dispozitat e KPC-së. Gjatë gjykimit gjykatat kanë respektuar të gjitha të drejtat procedurale të kërkuesve.

12. Subjekti i interesuar Avokatura e Shtetit ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

12.1 Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë kanë gabuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes. Në thelb pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore, zgjidhja e të cilave i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

12.2 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka argumentuar në vendimin përfundimtar vendimin e ndërmjetëm lidhur me rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen jashtë kompetencës së gjykatës civile, është i pabazuar. Gjykata e Apelit Tiranë ka zbatuar ligjin procedural, duke mos cenuar asnjë të drejtë të kërkuesve.

13. Gjatë proceseve gjyqësore Ministria e Financave dhe ajo e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës janë përfaqësuar secila në mënyrë të pavarur. Pas miratimit të strukturës së re të qeverisë në shtator të vitit 2017 u krijua Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka paraqitur parashtrime me shkrim me argumentet si vijojnë:

13.1 Kërkuesit nuk legjitimohen për sa i përket shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit të parashikuar

nga ligji. Pretendimi i tyre për shfuqizimin njëkohësisht të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është kontradiktor.

13.2 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë rezulton se plotëson standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe se mungesa e një arsytimi të detajuar nuk përbën të metë serioze në aspektin kushtetues.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

14. Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, pasi parashikohen si subjekte nga nenet 131/f/1 dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, gjatë parashtrimeve subjekti i interesuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka pretenduar se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis* për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga ligji. Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar është i pabazuar. Gjykata thekson se bazuar në nenin 131/1/f të Kushtetutës individët mund të drejtohen me kërkesë në Gjykatën Kushtetuese pasi të kenë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në çështjen në shqyrtim kërkuesit kanë paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 00-2016-1671, datë 25.5.2016 ka vendosur mospranimin e rekursit. Për rrjedhojë, kërkuesit kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe si datë e fillimit të afatit 2-vjeçar për paraqitjen e kërkesës është data 25.5.2016 e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”¹.

¹ Kërkesa është dërguar me postë në datën 28.2.2017, para hyrjes në fuqi të afatit 4-mujor të parashikuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar.



16. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae* kërkuesit kanë pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, duke argumentuar se Gjykata e Apelit Tiranë ka cenuar parimin e ligjshmërisë, pasi nuk e ka zgjidhur drejt çështjen dhe nuk ka hetuar mbi origjinën e sendit. Gjykata e Apelit ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi nuk ka zbatuar drejt dispozitat lidhur me ankimin kundër vendimit për mosshpallje të kompetencës lëndore, si dhe ka shkelur rregullat për formimin e ndërgjyqësisë. Ky pretendim është parashtruar edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka argumentuar qëndrimin e tij lidhur me shkaqet e parashtruara në rekurs.

17. Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e parashtruara nga kërkuesit vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të ligjshmërisë nga Gjykata e Apelit Tiranë është i lidhur me mënyrën e zbatimit, të interpretimit të ligjit dhe vlerësimin provave, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por janë në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Si rrjedhim, Gjykata bazuar në standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ka vlerësuar pretendimet për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

18. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi nuk ka pranuar kërkesën për shpalljen e moskompetencës lëndore, si dhe ka shkelur rregullat për formimin e ndërgjyqësisë. Sipas tyre, Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka bërë kalimin procedural dhe ka legjitimuar si palë në gjykim Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të cilat pas strukturës së re qeverisëse në tetor të vitit 2013, pra më shumë se 4 muaj para shqyrtimit të çështjes, nuk ekzistonin më me këto emërtime.

19. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42

të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar se termi “gjykatë” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 16, datë 27.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekursin për pretendime të shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit, pa i ndryshuar ato (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 17 datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkuesve për moskompetencën dhe ndërgjyqësinë janë parashtruar në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2013-2166 (416), datë 9.7.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1916, datë 16.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke vlerësuar kompetente në shqyrtimin e çështjes gjykatën civile dhe jo atë administrative. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë rezulton se kjo gjykatë i ka lënë detyra Gjykatës së Apelit për t’u dhënë zgjidhje pretendimeve të parashtruara nga kërkuesit, duke bërë cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen konkrete. Pas rishqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë, kërkuesit kanë paraqitur përsëri rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 00-2016-1671, datë 25.5.2016 ka vendosur mospranimin e tij.

21. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit Tiranë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj, duke respektuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për



rrijedhojë, pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesit kanë pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

23. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë,

përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete e natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi nr. 00-2016-1671, datë 25.5.2016, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban palët ndërgjyqëse, objektin, vendimet e mëparshme të gjykatave, si dhe palët që kanë paraqitur rekurs e kundërrkurs, duke parashtruar shkaqet për secilin prej tyre. Në përfundim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 480 të KPC-së, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk plotëson kriteret e parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

28. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit



kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë i plotëson standardet e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor, për rrjedhojë dhe ky pretendim i kërkuarve është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë